



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 878 Prot.

Fier, më 28/02/2022

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i Sekuestros)

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misioneve tona të ngarkuara nga Ligji, e shohim të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shume raste nëpërmjet Tij, është mundësuar shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - *“Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre”,* Ligjit nr.61/2012 - “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, Neni 107 i Tij (Ndihma e institucioneve të tjera” - *Të gjitha institucionet publike civile, si dhe Policia e Shtetit janë të detyruara të ndihmojnë, të japin akses në informacion si dhe të bashkëpunojnë me autoritetet doganore sa herë që këto të fundit e kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e këtij ligji*), në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - *“Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në*

prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”. kërkojmë nga ana Juaj :

♦ **“Shpalljen Publike”** për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të aktit administrativ – Vendimit të Rikuperimit me forcë të detyrimeve doganore/akcizës, të materializuara nga ana jonë, si vijon :

- Nr.2678/5 Prot., datë 24/09/2021, i materializuar për subjektin “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, me ushtrim të aktivitetit në Fier (Lagjja “Afrim i Ri”, Rruga e Seman- it, Pasuria 15/31-ND, kati i dytë), me administrator z.Giovanni Di Girolamo.
- Nr.2675/5 Prot., datë 24/09/2021, i materializuar për subjektin “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, me ushtrim të aktivitetit në Fier (Lagjja “ Sheq i Madh”, zona kadastrale nr. 3981, pasuria nr. 73/20), me administrator z.Ardjan Bishani.
- Nr.395/6 Prot., datë 15/12/2021, i materializuar për subjektin “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, me banim në Fier (“Aleksandër Zaka”, Ndërtesa nr.14, hyrja nr.2).

Bashkëngjitur, gjeni kopje të tre akteve të lartpërmendur.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes së aktit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Roland Mërtiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 2678/5 Prot.

Fier, më 24/09/2021

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori, subjekti “TRE DI GIO” sh.p.k me Nipt L92612404U, me seli në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Fier” .

Dega e Doganës Fier, me aktin administrativ - Vendimin e kontabilizimit Nr.146, me Nr.2678/4 Prot., datë 03/08/2021, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 53,285 (Pesëdhjetetremijë e dyqind e tetëdhjetepesë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor, si dhe të penalitetit doganor në shumën 50.000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/a,b të Kodit Doganor, për mosdhënie destinacion doganor në afat mallit, ndaj subjektit debitor “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, me ushtrim të aktivitetit në Fier (Lagjja "Afrim i Ri", Rruga e Semanit, Pasuria 15/31-ND, kati i dytë), me administrator z.Giovanni Di Girolamo.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, me anë të Shërbimit Postar, me anë të njoftimit elektronik, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Personi juridik debitor “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, i njoftuar, megjithëse ka kaluar afati ligjor, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 146, me Nr.2678/4 Prot., datë 03/08/2021, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 146, me Nr.2678/4 Prot., datë 03/08/2021, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “TRE DI GIO” sh.p.k, me NIPT L92612404U, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

VENDOSA:

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumenta me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "TRE DI GIO" sh.p.k, me NIPT L92612404U, personave të tretë, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "TRE DI GIO" sh.p.k, me NIPT L92612404U, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personit juridik - "TRE DI GIO" sh.p.k, me NIPT L92612404U, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale **103,285** (Njëqindetremijë e dyqindetëdhjetepesë) lekë, sipas Vendimit Nr.146, me Nr.2678/4 Prot., datë 03/08/2021, të Degës së Doganës Fier.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 2675/5 Prot.

Fier, më 24/09/2021

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori, subjekti “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, me seli në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Fier”.

Dega e Doganës Fier, me aktin administrativ - Vendimin e kontabilizimit Nr.147, me Nr.2675/4 Prot., datë 03/08/2021, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 306,907 (Treqindegjashtëmijë e nëntëqind e shtatë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor, si dhe të penaltetit doganor në shumën 50.000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/a,b të Kodit Doganor, për mosdhënie destinacion doganor në afat mallit, ndaj subjektit debitor “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, me ushtrim të aktivitetit në Fier (Lagjja “ Sheq i Madh”, zona kadastrale nr. 3981, pasuria nr. 73/20), me administrator z.Ardjan Bishani.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, me anë të Shërbimit Postar, me anë të njoftimit elektronik, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Personi juridik debitor “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, i njoftuar, megjithëse ka kaluar afati ligjor, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 147, me Nr.2675/4 Prot., datë 03/08/2021, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 147, me Nr.2675/4 Prot., datë 03/08/2021, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15,

datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumenta me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, personave të tretë, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personit juridik - “ALB - KING'S CERAMICA” sh.p.k, me NIPT L53231801J, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale **356,907** (Treqindpesëdhjetegjashtëmijë e nëntëqindeshtatë) lekë, sipas Vendimit Nr. 147, me Nr.2675/4 Prot., datë 03/08/2021, të Degës së Doganës Fier.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 3095/ Prot.

Fier, më 15/12/2021

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve të akcizës që debitori, subjekti “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, me banim në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Fier” .

Dega e Doganës Fier, me aktin administrativ - Vendimin e kontabilizimit Nr.145, me Nr.3095/4 Prot., datë 03/08/2021, ka vendosur sekuestrimin dhe më tej, konfiskimin e mallit 15 kg “duhan”, si dhe ndëshkimin me gjobë në masën e dyfishit të detyrimit fiskal të papaguar, në shumën 132.000 (Njëqindetridhjetedymijë) lekë, bazuar në nenin 94/1/a të Ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndaj subjektit debitor “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, me banim në Fier (“Aleksandër Zaka”, Ndërtesa nr.14, hyrja nr.2).

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I me anë të Shërbimit Postar dhe rezulton nga lajmërim marrje me kod bar RR638463171AA, se zarfi është rikthyer në Degën e Doganës Fier me shënimin “I panjohur”.

Në këto kushte Dega e Doganës Fier, ka vijuar procedimin administrative me kryerjen e lajmërimit publik, konkretisht me shkresën e saj nr.3901 Prot., date 28/09/2021, me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ” drejtuar Prefektit të Qarkut Fier, i cili ka konfirmuar njoftimin publik me shkresën nr.1192/1 Prot., datë 05.10.2021 me lëndë “Kthim përgjigje”; me shkresën e saj nr.3900 Prot., date 28/09/2021, me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ” drejtuar Bashkisë Fier, e cili ka konfirmuar njoftimin publik me shkresën nr.9108 Prot., datë 07.10.2021; me shkresën nr.3095/5 Prot., date 22/11/2021, me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim lidhur me njoftimin e subjektit debitor”.

Personi fizik natyror debitor “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, i njoftuar, megjithëse ka kaluar afati ligjor, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin e kontabilizimit të detyrimeve të akcizës Nr.145, me Nr.3095/4 Prot., datë 03/08/2021, si dhe nuk ka

ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.145, me Nr.3095/4 Prot., datë 03/08/2021, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 103 të Ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumenta me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, personave të tretë, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personit fizik natyror - “Mentor Skënder Malaj” me ID G81231047I, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale **132.000** (Njëqindetridhjetedymijë) lekë, sipas Vendimit Nr.145, me Nr.3095/4 Prot., datë 03/08/2021, të Degës së Doganës Fier.

K R Y E T A R

Roland Mërtiri

